



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2350 / Prot.
1

Tiranë, më 3.7.2020

URDHËR

Nr. 209, Datë 3.7.2020

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,
“BACHELOR” NË “PSIKOLOGJI”, TË UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga “Bachelor” në “Psikologji” me kohëzgjatje normale 4 vite akademike (8 semestra), në “Bachelor” në “Psikologji” me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Psikologji”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji”, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, sipas raportit të vlerësimit, bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.
4. Universiteti i New York-ut Tiranë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i New York-ut Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Nisur sa më sipër vlerësoj se programi i studimit “Bachelor” në “Psikologji” i paraqitur nga IAL “New York”

Plotëson standardet dhe kriteret për riorganizim si program studimi “Bachelor” me kohëzgjatje 3 vite akademike me sugjerimet e mëposhtme:

- a. Institucioni të rrisë numrin e stafit akademik me tituj e grada shkencore me formim të mirëfilltë psikologjik, pasi 4 pedagogë të brendshëm me formim në fushën e psikologjisë janë të pamjaftueshëm për realizimin me sukses të objektivave të këtij programi studimi.
- b. Në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë në fuqi, titullarët e lëndëve duhet të jenë të kategorisë “Profesor” dhe lektorët e lëndëve të kategorisë “Doktor i shkencave”.
- c. Institucioni të realizojë një rishpërndarje të ngarkesës mësimore në auditor për leksion, seminar dhe veprimtari të tjera bazuar në numrin e ECTS, pasi një lëndë me 8 ECTS nuk mund të ketë njësoj ngarkesën mësimore në auditor si një lëndë me 4 ECTS.